



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 30/2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9723, DATË 3.5.2007,
“PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 22, pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Aplikimi për ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike të ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.”.

Neni 2

Në nenin 26, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit ose nga administrator i shoqërisë kur autorizohet, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike, me të cilat lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet mund të kryhet, gjithashtu, dhe nga anëtari, ortakut apo aksionari, të cilit ato i përkasin, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.”.

Neni 3

Në nenin 74, pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 me këtë përmbajtje:

“3/1. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 4/1, të nenin 22, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë.

3/2. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 43, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 100 000 lekë.”.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 17.6.2019